



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008 dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010 dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **dytë** të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më **30.03.2016**, dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës;**
- 2. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;**
- 3. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Mati 2”;**
- 4. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes “Sofalia”;**
- 5. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1”;**
- 6. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës;**
- 7. Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;**
- 8. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;**
- 9. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave SHML “Gjimnazi Matematikorë” për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të**

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*

- jashtëzakonshme "Atomi";
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
  11. Caktimi i anëtareve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
  12. Miratimi i Planit Lokal i Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar;
  13. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
  14. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;
  15. Të ndryshme;
  16. Pyetje dhe përgjigje.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01. nr. 006-66964, më 22.03.2016

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*